

DOKUMENT PËR POLITIKAT PUBLIKE PËR PJESMARRJE TË DREJTPËRDREJT TË QYTETARËVE NË VENDIMARRJE NË NIVEL LOKAL



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN



SHKUP, SHKURT 2020

DOKUMENT PËR POLITIKAT PUBLIKE PËR PJESMARRJE TË DREJTPËRDREJT TË QYTETARËVE NË VENDIMARRJE NË NIVEL LOKAL

Botues: Forum QHSD

Autorë: Boris Sharkovski, Astrit Rexhepi, Aleksandar Nikoliq Pisarev, Mitko Nikolov, Kadrije Zhaku, Petre Mrkev, Jordanço Minevski dhe Katerina Kaleshkovska

Redaktor: Gjuner Ismail

Recenzent: Sllagjan Penev

Lektorimi: Violeta Karaxhovska Stojanova

Përkthimi në gjuhën shqipe: Metin Muaremi

Lektorimi në gjuhën shqipe: Osman Rexhepi

Përmbajta

INFORMACION PËR AUTORËT E HULUMTIMIT	3
HYRJE.....	4
DISA RASTE TË PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE NË NIVEL LOKAL.....	5
Rajoni Juglindor.....	5
Rajoni Jugperëndimor	7
Rajoni planor i Shkupit.....	9
Rajoni Verilidnor	Error! Bookmark not defined.
Rajoni Lindor	Error! Bookmark not defined.
Rajoni i Pollogut	Error! Bookmark not defined.
Rajoni Pellagonisë	Error! Bookmark not defined.
Rajoni i Vardarit	Error! Bookmark not defined.
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	Error! Bookmark not defined.
Përfundime:	17
Rekomandime:	19

Ky publikim është përgatitur nga Forumi - Qendra për Kërkime Strategjike dhe Dokumentim nga Shkupi (FORUM-CSID) me mbështetjen e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Mendimet e shprehura në këtë publikim, "Dokument për politikën publike për pjesëmarrje të drejtpërdrejt të qytetarëve në vendimarrje në nivel lokal", janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

INFORMACION PËR AUTORËT E HULUMTIMIT

Forumi - Qendra për Kërkime Strategjike dhe Dokumentim nga Shkupi (FORUM-CSID) është një organizatë e krijuar për t'u angazhuar në zhvillimin e demokracisë, mbështetje për të drejtat e njeriut dhe marrëdhëniet ndëretnike dhe për të ndihmuar në formimin e politikave kombëtare në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe krijimin e kushteve për integrimin euro-atlantik. Qendra promovon politika publike të shëndosha dhe të zbatueshme, mbështet bashkësi dhe ndihmon në fusha të ndryshme të reformës së shërbimit publik. Ky dokument politik është pjesë e aktiviteteve të rrjetit joformal “Qytetarë aktiv për qeverisje të mirë”, të mbështetur nga projekti i USAID për Pjesëmarrjen qytetare.

Dokumenti është krijuar në bazë të një studimi mbi përdorimin e formave të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje lokale, të implementuar nga FORUM-CSID në partneritet me shtatë organizata: Qendra për edukim dhe zhvillim nga Tearca, Etniteti nga Struga, Planetum nga Strumica, Fondacioni për zhvillimin e komunitetit lokal nga Shtip, Unioni për parandalimin kundër delikuencës së të miturve nga Kavadari, Iniciativat rinore për dialog dhe bashkëpunim nga Manastiri dhe Qendra qytetare për zhvillim të qëndrueshëm EGRI nga Kriva Palanka.

Një nga qëllimet kryesore të projektit “Qytetarë aktiv për qeverisje të mirë” është të edukojë qytetarët për mundësitë e përfshirjes së tyre aktive në vendimmarrje në lidhje me çështjet lokale. Shumica e partnerëve në këtë projekt, me përvojat e tyre të kryerjes së aktiviteteve në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në nivelin lokal, janë përballur me problemin e demotivimit të aktivizimit ose mungesës së besimit në mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në vendimet e qeverisë për shkak të dispozitave ligjore që përcaktojnë se një përqindje e lartë e qytetarëve duhet të regjistrohen për të mbështetur nismat qytetare dhe format e tjera të vendimmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve për çështje. Për këtë arsye, partnerët nga “Qytetarë aktivë për qeverisje të mirë” kanë vendosur të analizojnë më shumë raste të iniciativave civile nga të gjitha rajonet planore në vend, në mënyrë që të hapin një debat publik për nevojat për ndryshime në legjislacionin dhe praktikën e vendimmarrjes direkte në nivel të vetqeverisjes lokale.

HYRJE

Korniza ligjore për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje në nivelin lokal është rregulluar me **Ligjin për vetëqeverisjen lokale** (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 5 e 29 janarit 2002). Ajo përkufizohet si "përfshirje individuale ose kolektive e qytetarëve të komunës në vendimmarrje për çështje me rëndësi lokale në nivele të ndryshme të vendimmarrjes" (LVL, neni 2). Ligji gjithashtu parashikon që kostot e zbatimit të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje të përballohen nga buxheti i komunës (LVL, neni 25).

Iniciativa e qytetarëve mund të propozohet nga qytetarët në këshillin komunal nëse mbështetet nga të paktën 10% e votuesve komunalë (LVL, neni 26). Takimet e qytetarëve mund të thirren nga kryetari i komunës me iniciativën e tij / saj, me kërkesë të këshillit bashkiak ose me kërkesën e të paktën 10% të votuesve të komunës ose vetëqeverisjes lokale, me të cilën ka të bëjë çështja e veçantë (LVL, neni 27). Ndërsa një referendum mund të thirret nga këshilli komunal me iniciativën e tij dhe nëse kërkojnë të paktën 20% e elektoratit komunal, këshilli komunal është i detyruar të thërrasë një referendum.

Kjo formë (referendumi) e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve rregullohet me ligje të tjera. Referendumi në nivelin lokal nuk mund të thirret për çështje që lidhen me buxhetin dhe buxhetin përfundimtar të komunës, për organizimin e administratës komunale dhe për çështje që këshilli vendos me shumicë votash të anëtarëve të këshillit të cilët janë të pranishëm dhe me shumicë votash të anëtarëve të këshillit të cilët janë të pranishëm, të cilët u takojnë komuniteteve jo-shumicë në komunë (**Ligji për Referendum dhe format e tjera të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve**, neni 40).

Praktikat aktuale demokratike, si dhe traditat, përfshijnë edhe forma të tjera të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje për çështje me interes të komunës/qytetarëve dhe janë të përfshira në ligje të përgjithshme ose të veçanta, si dhe në akte të vetëqeverisjes lokale.

Kështu, si në LVL ashtu edhe në ligjet e tjera, qytetarët kanë të drejtë, individualisht ose kolektivisht, të paraqesin **ankesa dhe propozime** për punën e organeve komunale dhe administratës komunale.

Gjatë hartimit të rregulloreve komunale, këshilli ose kryetari mund të organizojnë më parë një **tribunë publike**, të kryejnë **sondazhe** ose sugjerime të kërkuara nga qytetarët.

Në dhjetë vitet e kaluara, këtyre formave të këshillimit të komunitetit në komuna u bashkua edhe një proces i quajtur **Forumet në bashkësi**. Shumica e komunave në Maqedoninë e Veriut kanë përfshirë forume në statutet e tyre, kryesisht si rezultat i programit për zhvillimin e formave të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen në vetëqeverisjen lokale.

DISA RASTE TË PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË VENDIMARRJE NË NIVEL LOKAL

Në këtë document për politika ne përpiqemi të analizojmë shembujt më domethënës të formave të pjesëmarrjes së qytetarëve në dhjetë vitet e fundit brenda njësive të vetëqeverisjes lokale në Maqedoninë e Veriut. Analiza bazohet në një studim të realizuar nga përfaqësues të tetë OJQ-ve nga tetë rajonet planore (FORUM-CSID Shkup, Qendra për edukim dhe zhvillim nga Tearca, Etniteti nga Struga, Planetum nga Strumica, Fondacioni për zhvillimin e komunitetit lokal nga Shtip, Unioni për parandalimin kundër delikuencës së miturve nga Kavadari, Iniciativat rinore për dialog dhe bashkëpunim nga Manastiri dhe Qendra qytetare për zhvillim të qëndrueshëm EGRI nga Kriva Palanka), të cilët kontaktuan 127 qytetarë në periudhën korrik - shtator 2019, përfaqësues nga komunat dhe shoqatat të cilët kanë ngritur iniciativa qytetare deri te komunat. Qëllimi i studimit ishte të merrte të dhëna më specifike për llojin dhe numrin e iniciativave nga qytetarë ose grupe qytetarësh që rezultuan në vendimmarrje nga autoritetet komunale. Para kryerjes së intervistave me përfaqësuesit të iniciativave të qytetarëve dhe përfaqësuesit e administratave komunale në të cilat janë propozuar marrje vendimesh në kuadër të iniciativave nga qytetarët, studiuesit rishikuan informacionin e disponueshëm për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje në nivelin lokal, dhe në disa raste kërkuan informata shtesë nga komunat, duke përdorur të drejtën për qasje të lirë të informatave me karakter publik.

Duke vepruar kështu, si një kornizë e nevojshme metodologjike - supozim, morëm parasysh kohën e realizimit të nismave, të cilat në disa raste zgjatën disa vjet, dhe situata e përgjithshme politike në shoqëri pati një ndikim të madh. Disa nga nismat tregojnë se trazirat politike, përfshirë ndryshimet në strukturat drejtuese në nivelin qendror dhe lokal, kanë ndikuar në vendimet që kanë qenë objekt i nismave qytetare.

Sipas këtij studimi, forma më e zakonshme e pjesëmarrjes janë nismat qytetare që kërkojnë që popullsia lokale të rinovojë një ndërtesë ekzistuese ose të ndërtojë një të re.

Propozimet dhe ankesat e qytetarëve, të cilat shpesh përdoren nga qytetarët dhe të cilat vendosen në nivelin e këshillit komunal, kryesisht i referohen kërkesës për ndihmë financiare nga buxheti i komunës, kur ka zjarr ose ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore në territorin e komunës përkatëse ose kur ekziston një nevojë urgjente për të ndihmuar familjet në kushte sociale të rrezikuara.

Sa i përket nismave për referendum, ato zakonisht shpallen nga këshillat komunal, pa mbledhur nënshkrime të qytetarëve të komunës që përbëjnë 20% të votuesve në të njëjtën komunë.

RAJONI JUGLINDOR

Referendumet në të cilat qytetarët u shprehën në favor ose kundër hapjes së minierave në komunat e Gjevgjelisë, Bogdancit, Dojran, Bosilovës, Novo Selo janë shembuj në të cilat vendimi për t'i thirrur ata është bërë pa mbledhur nënshkrime të 20% të votuesve të regjistruar në nivelin komunal. Një

përrjashtim është referendumi për të njëjtën çështje në Komunën e Valandovës, e cila u thirr pasi këshilli komunal fillimisht hodhi poshtë iniciativën e qytetarëve, dhe pas nënshkrimeve të mbledhura të mbi 20% të votuesve të regjistruar në komunë, këshilli vendosi në një seancë të re që të mbahet referendumi.



Në Gjevgjeli **iniciativa për shpalljen e referendunit u paraqit nga shoqata "Shpëtim për ne - Gjevgjeli"**. Më pas, Njësia për Zhvillim ekonomik lokal në Komunën e Gjevgjeliisë u paraqit si iniciator i referendunit. Referendumi u mbajt në 23 Prill 2017, me gjithsej 13,384 votues, ose 68.8% e qytetarëve me të drejtë vote. Prej tyre 13,097 qytetarë votuan kundër hapjes së minierave në territorin e Komunës së Gjevgjeliisë, pra në malin Kozuf.



Me iniciativën e shoqatës qytetare "Shpëtim për Bogdancin", pa mbledhur numrin e kërkuar të nënshkrimeve, këshilli i Komunës së Bogdancit vendosi të mbaj referendun. Në Bogdanci ishin dy pyetje, nëse qytetarët ishin për ndërtimin e minierës Kazandol dhe nëse qytetarët ishin për ose kundër hapjes së minierave dhe komplekseve minerore për burimet minerale metalike në Komunën e Bogdancit. Referendumi u mbajt më 11 qershor 2017. Pjesëmarrja ishte 61% (votuan 4,205 nga 6,918 votues të regjistruar), që do të thotë se referendumi ishte i suksesshëm, kurse me mbi 95% votuan kundër.

Referendumi në komunën e Dojranit gjithashtu pati dy pyetje. Njëra ishte nëse qytetarët ishin për ose kundër hapjes së minierës Kazandol, dhe e dyta nëse ishin për ose kundër hapjes së minierave në territorin e Komunës së Dojran. Pyetja e dytë ishte për shkak të mundësisë së hapjes së një minierë tjetër në malin Belasica (Miniera e Bashiboz). **Këshilli mori vendimin për të mbajtur referendun pa mbledhur numrin e kërkuar të nënshkrimeve.** Referendumi u mbajt më 23 korrik 2017, me 25 vota më shumë se cenzusi i kërkuar, pasi 1,407 votues nga gjithsej 2.747 votues të regjistruar votuan. 96% e votuesve që votuan kundër hapjes së minierave, kurse në pyetjen për hapjen e minierës në Kazandoll, 95% e votuesve në referendun votuan gjithashtu kundër.

Nisma e Qytetarëve "Shpëtim për Luginën e Strumicës - Stop minierës së Illovcës", mbledhi 115 nënshkrime dhe i dorëzoi ato në këshillin e Komunës së Bosillovës, pas së cilës këshilli mori një vendim për të mbajtur referendum. Referendumi u mbajt në 3 shtator 2017, dhe pjesëmarrja ishte 32.5% e votuesve të regjistruar në komunë, ku 3.992 votues shfrytëzuan të drejtën e tyre për të votuar në të dy pyetjet: "A jeni" për "ose" kundër "hapjes së minierës së bakrit dhe arit në Illova?" dhe "A jeni "për" ose "kundër" hapjes dhe gërmimit të metaleve ose xeheve metalike? "

E njëjta procedurë si në Bosillovë, **me të njëjtën iniciativë qytetare "Shpëtim për Luginën e Strumicës - Stop minierës së Illovcës"**, ka ndodhur edhe në Novo Selo. Pasi mbledhjes së të paktën 100 nënshkrimeve nga nisma qytetare, këshilli vendosi të mbaj referendum me 17 gusht 2017. Referendumi u mbajt me 17 Shtator, dhe në 20 vendvotime në nivel komunal, nuk doli numri i nevojshëm i qytetarëve, 5.720 (50% e votuesve të regjistruar) për të votuar për ose kundër minierës Illova në Malin Ograzden.

Sipas iniciatorëve të Shoqatës "Lugina e shëndetshme", arsyeja e dështimit të referendumit është lista e votuesve, e cila nuk pasqyron pamjen e vërtetë në terren, pasi rreth 40% e banorëve të Komunës së Novo Selo janë shpërngulur jashtë vendit.

Valandova është komuna e vetme ku u mbledh numri i duhur (20%) i nënshkrimeve për mbajtjen e referendumit, pasi këshilli komunal nuk e pranoi iniciativën (dorëzuar me minimum 100 nënshkrime të mbledhura) për të vendosur për referendum.

Këshilli morri vendim që nisma qytetare "Shpëtim për Valandovën," të mbledhë 2000 nënshkrime të nevojshme, në mënyrë që vetëqeverisja lokale të vendosë për shpalljen e referendumit. Nënshkrimet e kërkuara u mbledhën vetëm në një ditë, kështu që Këshilli vendosi të shpall referendumin me 20 gusht 2017. Referendumi dështoi sepse pjesëmarrja ishte 46.11%.

Në një bisedë me një përfaqësues të qytetarëve që inicuan procedurën e referendumit, u vërejt se ka pasur probleme gjatë gjithë procedurës, siç është një shembull që administratorët janë udhëzuar nga kryetari i atëhershëm i Valandovës që të vonojnë arhivimin e nënshkrimeve dhe kërkesën e referendumit. Për më tepër, përfaqësuesit e iniciativës besojnë se komuna ishte e detyruar me ligj që të promovojë dhe informojë qytetarët për referendumin, por nuk ka pasur asnjë aktivitet nga ana e komunës, përveç individëve në komunë që kanë punuar për të parandaluar daljen e referendumit. Sidoqoftë, iniciatorët janë akoma të kënaqur me bashkëpunimin me disa këshilltarë dhe përfaqësues të Komisionit shtetëror zgjedhor në nivel komunal, të cilët pretendojnë se kanë bërë punën e tyre në mënyrë profesionale.

RAJONI JUGPERËNDIMOR

Në rajonin Jugperëndimor, kemi analizuar rastin e inicimit të një referendumit në Komunën e Debërcës, pas një vendimi të miratuar më parë nga Këshilli i Komunës së Debërcës, më 14 shtator 2017. Më 15 tetor 2017, së bashku me zgjedhjet lokale, u mbajt referendum për ndërtimin e një deponie rajonale në zonën e fshatit Godivje. Nga gjithsej 4,625 qytetarë të regjistruar në listën e votuesve, 3.149 qytetarë ose 68% e numrit të përgjithshëm të votuesve votuan në referendum, nga

të cilët 2,746 ose 87% votuan kundër ndërtimit të një deponie rajonale, ndërsa 297 ose 13% votuan për ndërtimin e një deponie rajonale.

Para referendimit, në fshatin Godivje u krijua një organ koordinues nga të gjithë përfaqësuesit nga zonat rurale, pra 33 bashkësive lokale në të gjithë komunën. Ky organ ka përgatitur gjithashtu një analizë (broshurë) që përshkruan argumentet pse një deponi rajonale nuk duhet të ndërtohet në fshatin Godivje.

Sipas një përfaqësuesi të trupit koordinues, popullata në Komunën e Debarcës nuk ishte informuar sa duhet për procedurën e vendimmarrjes për ndërtimin e një deponie rajonale në këtë territor. Ata e zbuluan shumë vonë, dhe përmes mediave. Qytetarët u dakorduan që të informojnë të gjitha bashkësitë lokale dhe të organizojnë një tubim të qytetarëve në fshatin Godivje. Në korrik 2017, u mbledhën më shumë se 200 qytetarë dhe përfaqësues të bashkësive lokale, dhe ishin të ftuar edhe Këshilltarët e Komunës së Debarcës dhe Kryetari i atëhershëm. Pjesëmarrësit shprehën mosmarrëveshjen e tyre për zbatimin e një projekti të tillë në territorin e Komunës së Debarcës.

U dakorduan të ndërmarrin veprime të caktuara për t'i treguar Qeverisë se ky vendim ishte i gabuar, në mënyrë jo transparente dhe se ai duhet të ndalet dhe rishqyrtohet, pasi popullata e kësaj komune nuk është dakord të ndërtojë një deponi të tillë rajonale në këtë zonë. Ata publikuan të gjitha faktet që kishin kundër ndërtimit të deponisë në një broshurë, dhe u'a dorëzuan shtatë institucioneve: Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Ekologjisë, Kryetarit të Komunës së Debarcës, Kryetarit të Komunës së Ohrit, Zyrës së UNESCO-s dhe Zyrës së Bashkimit Evropian në Shkup. Përgjigja u mor vetëm nga Zyra e Bashkimit Evropian në Shkup.

Në një tubim ku morën pjesë kryetari dhe përfaqësuesit e këshillit, këshilli vendosi me iniciativën e vet të shpallë referendum lokal që qytetarët do mund të shprehin mendimet e tyre. Përfaqësuesit e trupit koordinues morën pjesë në seancën ku këshilltarët morën iniciativën dhe më pas vendosën të mbajnë referendum, me pyetjen "A jeni për apo kundër ndërtimit të një deponie rajonale të mbeturinave të ngurta në territorin e Komunës së Debarcës?"

RAJONI PLANOR I SHKUPIT

Ngjashëm me rastin e lartpërmendur në Komunën e Debarcës, u mbajt referendum në Komunën Qendër në vitin 2015



Nisma, e cila mori mbështetjen e shumë qytetarëve të Shkupit, u nis në pranverën e vitit 2013, si përgjigje për ndryshimin e fasadës në Qendrën Tregtare të Qytetit (GTC). **Nisma "E dua GTC-në" erdhi nga shoqatat qytetare si dhe shumë aktivistë qytetarë dhe arkitektë.** Aktiviteti i parë madhor dhe i dukshëm i iniciativës që tregoi se qytetarët e Shkupit nuk do ta pranonin me lehtësi rimodelimin e objektit është "përçafimi i parë i GTC" i organizuar në formën e një proteste paqësore në 14 qershor 2013, në të cilën morën pjesë rreth 3,000 qytetarë.



Foto: Vanco Dzambaski

Nisma "E dua GTC" arriti të krijojë bashkëpunim me autoritetet komunale pas ndryshimit të qeverisë në 2013 në Komunën Qendër. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, dhe me kërkesë të iniciativës të paraqitur zyrtarisht nga Shoqata e Arkitektëve në Qershor 2014, u mor një vendim në mbledhjen e Këshillit të komunës Qendër në Mars të vitit 2015 për të mbajtur referendum në nivelin komunal, në të cilin referendum qytetarët do të shprehen për të ardhmen e GTC-së. Referendumi u mbajt në 26 Prill 2015 dhe 17,655 votues dolën në votime në Komunën Qendër, pra 40.53% e numrit të përgjithshëm të qytetarëve të regjistruar në listën e votuesve. Sipas të dhënave zyrtare të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, 16.836 qytetarë ose 95.4% votuan për ruajtjen e fasadës ekzistuese të simbolit arkitektonik të Shkupit, ndërsa 659 qytetarë votuan kundër saj.

Disa muaj më vonë, në Komunën e Karposhit, filloi një procedurë për të ndaluar sjelljen e një plani të detajuar urbanistik (PDU) për Karposh 4. Në korrik 2015, rreth njëqind **qytetarë të vendbanimit u mboldhën në një tubim spontan**, nga revolti i shkaktuar nga procedura për të sjell një PDU në Karposh 4, më konkretisht me mënyrën se si u krye sondazhi i opinionit publik. Kërkesa e tyre ishte përsëritja e procedurës.

Meqenëse nuk morën përgjigje pozitive nga Komuna e Karposhit, ata vendosën të përdorin të drejtën për të filluar një iniciativë qytetare në nivel lokal. Ata u bënë thirrje Komisionit shtetëror zgjedhor (KSHZ), prej ku u kërkuar të mbledhin 100 nënshkrime nga qytetarët e komunës dhe t'i dërgojnë ato në zyrën rajonale të KSHZ-së. Ata u mbledhën në zyrën rajonale të KSHZ-së për disa orë. KSHZ më pas dha 30 ditë afat për të mbledhur nënshkrime të 10% të qytetarëve të Karposhit me të drejtë vote, d.m.th. për të mbledhur nënshkrime të rreth 5,500 qytetarëve.

Me aktivizmin në terren, mediat sociale dhe mediat tradicionale, me vullnetarë të angazhuar që i kan vozit të moshuarit dhe të pafuqishmit deri në zyrën e Komisionit shtetëror zgjedhor, iniciatorët arritën të mbledhin 2.600 nënshkrime që nuk ishin të mjaftueshme për ta bërë nismën qytetare të suksesshme, por qëllimi u arrit sepse PDU problematik nuk u votua. Pavarësia dhe motivimi i dukshëm i qytetarëve megjithatë fitoi, dhe pastaj zyrtarët e pushtetit vendor, kryetari i komunës dhe

shumica në këshillin komunal nuk guxuan të imponojnë një zgjidhje kundër së cilës qëndruan kaq shumë qytetarë.

Ka pasur një përpjekje të iniciatorëve për të mbledhur një tubim i qytetarëve në nivelin e vetëqeverisjes lokale, pasi që sipas nenit 27 të LVL-së, tubim të qytetarëve mund të thirret nga kryetari i komunës me iniciativën e tij, me kërkesë të këshillit ose me kërkesën e të paktën 10% nga votuesit e komunës ose bashkësia lokale së cilës i adresohet çështja e veçantë. Tubimi nuk u organizua sepse kryetari i Komunës së Karposhit u përgjigj se ishte e pamundur për shkak të provokimeve dhe se për të organizuar një tubim qytetar duhet të mbledheshin nënshkrimet përsëri në zyrën komunale të KSHZ

RAJONI VERILIDNOR

Në vitin 2008, një iniciativë për rinovimin e një kinemaje u nis në Kratovo, e cila ishte në rrënoja. **Nisma u nis nga klubi rinor lokal i OJQ-së Qendra rajonale për zhvillim të qëndrueshëm nga Kratova** dhe konsistonte me organizimin e një ngjarje publike në qiell të hapur të quajtur "Unë e dua kinemanë!" Po ti? " Ngjarja përfshinte një shfaqje të filmave të shkurtër nën qiell të hapur dhe një koncert nga një grup muzikor, dhe gjatë gjithë aktivitetit u realizua peticion nga qytetarë që mbështesin iniciativën për rinovimin e kinemasë.

Peticioni mblodhi 157 nënshkrime dhe ai u dërgua me letër deri te Komuna, Kratovë. Viti i parë nuk pati përgjigje, dhe më vonë në kohën e aplikimit për një grant nga komuna, Qendra rajonale për zhvillim të qëndrueshëm e Kratovës u kontaktua për ri-dorëzimin e peticionit, i cili u përdor si shtojcë e aplikimit të projektit. Kërkesa për projektin e komunës për rinovimin e sallës së kinemasë u miratua nga donatori dhe salla e kinemasë u rinovua plotësisht në vitin 2012.

Një anëtar i klubit rinor të Qendra rajonale për zhvillim të qëndrueshëm, Kratovë, i cili ishte koordinator i iniciativës, thotë se qëllimi i tyre ishte që në një mënyrë inovative dhe kreative të nxitet iniciativë për çështje për të cilën do të inicohet peticion. Kjo duhet të arrihet duke dërguar një mesazh tek autoritetet që Kratovës i mungon jeta shoqërore. Sipas nismëtarëve, është pikërisht rindërtimi dhe ri-funksionimi i kinemasë që do të kontribuojë në një jetë më të mirë dhe më kualitative sociale. Në këtë aktivitet morën pjesë kryesisht të rinj dhe gjatë shfaqjeve të filmit u mblodhën nënshkrime peticionesh.

Ata e panë idenë e mbledhjes së nënshkrimeve si një dokument i cili do të tregonte nevojën e të rinjve për të dalë me një ide, me të cilin gjithashtu do të provokonte në një farë mënyre komunën që të përfshijë rindërtimin e kinemasë në programin vjetor të Komunës së Kratovës për vitin e ardhshëm.

Nisma, së bashku me peticionin e bashkangjitur, iu dorëzua Komunës së Kratovës. Nisma u zbatua disa vjet më vonë.

Një përfaqësues i Komunës së Kratovës i cili u kontaktua për qëllimin e këtij hulumtimi thotë se iniciativa fillimisht u pranua si ide e mirë nga autoritetet e komunës dhe se përfaqësuesit e komunës morën pjesë në këtë aktivitet në mbështetje. Sidoqoftë, për shkak të mungesës së fondeve të mjaftueshme, nuk kishte mundësi që ajo të financohej nga Komuna e Kratovës dhe e vetmja zgjidhje ishte të përkrahej financiarisht nga një donator. Që nga koha kur nisma u dorëzua në zbatimin e saj,

nuk kishte komunikim midis organizatorëve të iniciativës dhe autoriteteve lokale. Më vonë, zyrtarët komunalë u kërkuan nismëtarëve të rivendosin propozimin për rindërtimin e kinemasë, pasi kishte dalë një mundësi për donacione të huaja. Një nga kushtet për marrjen e donacionit ishte bashkëpunimi midis autoriteteve lokale dhe sektorit civil.

Sipas përfaqësuesit të Komunës së Kratovës i cili u përfshi aktivisht në realizimin e nismës, ishte një iniciativë e suksesshme që u pranua që në fillim si ide e mirë, e pasuar nga një ngjarje e suksesshme. Më vonë, projekti u votua së pari në listën prioritare të projekteve në Forumet në bashkësi dhe hyri në Programin e Kulturës të Komunës së Kratovës dhe më pas u miratua nga këshilli komunal. Projekti, për rëndësinë e tij më të gjerë, u riemërua si një qendër multimedia dhe u aplikua në Agjencinë Zvicerane të Zhvillimit e cila aprovoi një pjesë të fondeve të nevojshme, ndërsa pjesa tjetër u siguroi nga Ministria e Kulturës dhe nisma u zbatua plotësisht.

Në kushtet e thirrjes publike potencohet që përparësi do t'i jepej projekteve që përfshijnë bashkëpunimin ndërmjet komunës dhe sektorit civil, pas së cilës Komuna e Kratovës iu drejtua Qendrës rajonale për zhvillim të qëndrueshëm, Kratovë për të rivendosur nismën e përdorur si bazë për plotësimin e kushteve nga thirrja publike.

Kjo çështje duhet të theksohet në veçanti sepse donatori insistoi në bashkëpunim në mes autoriteteve lokale dhe nismës qytetare, e cila si model mund të ishte e suksesshme dhe të krijonte një rrugë pozitive përpara. Kjo do të forconte mekanizmat demokratikë dhe do t'i shërbente qytetarëve si një nxitje për të ndërmarrë nisma.

Të pyetur pse u vendos që si Komunë ta vendosin këtë iniciativë si një projekt prioritar, përfaqësuesi tha se ishte për shkak të përfshirjes dhe përfshirjes së lartë të kategorive të ndryshme të qytetarëve rreth nevojës, dhe veçanërisht përfshirjes së të rinjve në Kratovë që e mbështetën fuqimisht idenë.

Sot vendi po funksionon në kuadër të Qendrës Kulturore dhe është një vend ku realizohen ngjarje kulturore.

RAJONI LINDOR

Në komunat e rajonit planor lindor nga 2005 deri në 2019, format e parashikuara me ligj të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje në nivelin lokal, rrallë përdoren. Një numër i iniciativave për organizimin e një referendumi në komunat e Berovës dhe Vinicës janë të dukshme, por asnjë iniciativë nuk është pranuar, dhe pas refuzimit propozuesi nuk ka filluar procedurë për mbledhjen e nënshkrimeve. Komunat përdorin forma të pjesëmarrjes së qytetarëve që nuk kanë të bëjnë me përmbushjen censuzit për shpalljen dhe pranimin e tyre, siç janë tubime, sondazhe, propozime, matje të opinionit publik dhe të tjerë. Të 11 komunat në këtë rajon, në statutin e tyre, kanë miratuar Forumet në bashkësi si një mjet për pjesëmarrje qytetare, dhe vetëm komuna e Berovës ka organizuar në mënyrë të pavarur një forum buxheti.

Si shembull i pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje në nivelin lokal në këtë rajon, e theksojmë Komunën e Vinicës ku mbi bazën e një initiative qytetare në vitin 2009 u mor një vendim për përfshirjen e zonës ekonomike "ILA" në Planin e detajuar urbanistik. Nisma u paraqit nga 42% e pronarëve të parcelave kadastrale në zonë. Ndër iniciatorët kishte edhe anëtarë të administratës komunale që lehtësuan tërë procedurën. Këshilli komunal diskutoi këtë iniciativë dhe filloi një

procedurë për përfshirjen në Planin e detajuar urbanistik dhe organizoi një debat publik për planin urbanistik. Pas miratimit të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve në vitin 2012, kjo iniciativë u miratua nga këshilli komunal.

RAJONI I POLLOGUT

Ngjashëm si në rajonin lindor, rajoni planor I Pollogut deri më tani nuk ka pasur një referendum lokal, dhe në vetëm një komunë, Komunën e Bogovinës, ka pasur 17 nisma qytetare.

Takime të qytetarëve janë mbajtur, por ato janë gjithmonë me iniciativën e kryetarit. Në disa komuna, tubim qytetarësh ka thirr edhe këshilli komunal, por ai ishte nën presionin e një grupi qytetarësh kundër vetë këshilltarëve. Një shembull i tillë është prerja e pyllit mbi zonën e fshatit Tearce. Qytetarët përmes protestave u bënë nën presion këshilltarëve për të thirr një tubim me kryetarin për të diskutuar çështjen. Nuk ka asnjë shembull ku një komunë nga rajoni planor i Pollogut është iniciuar tubim i qytetarëve me mbledhjen e 10% të nënshkrimeve nga lista e votuesve. Përqindja e lartë e nënshkrimeve të kërkuara është një pengesë kryesore për të pasur raste të tilla.

Sidoqoftë, kur aktivistët, OJQ-të dhe grupet joformale kanë paraqitur një iniciativë për këshillat komunal në këtë rajon, ato janë vendosur në rendin e ditës të seancave të këshillave komunalë.

Shumë ndryshime në komunat e rajonit planor të Pollogut kanë ardhur përmes presionit të drejtpërdrejtë nga qytetarët përmes protestave të organizuara. Edhe pse ky mekanizëm nuk është i paraparë me Ligjin për vetëqeverisje lokale, ai është akoma më i suksesshmi dhe më i përdoruri. Qytetarët shpesh kanë marrë vendime në vend përmes pjesëmarrjes në protesta. Një nga protestat më të suksesshme është mbyllja e Jugohrom, si ndotësi më i madh në Tetovë dhe rrethinë, dhe për qëllimet e kësaj analize ne kemi parashtruar Iniciativën kundër ndotjes së Tetovës.

Sipas një përfaqësuesi të nismës, pasi u postuan shumë komente në rrjetet sociale në lidhje me ndotjen kancerogjene të ajrit në qytet, ndodhi edhe takimi ndërmjet disa aktivistëve (përfshirë gazetarë, arkitektë, profesorë, studentë, stilistë). Në mbledhje ata vendosën të konsultohen me ligjet dhe të kërkojnë përgjigje nga Qeveria, Komuna e Tetovës, Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapsinor për problemin e ndotjes dhe lejen për të operuar fabrika metalurgjike Jugohrom, ku nuk u instaluan filtra oxhaku, mirëpo që shihet qartë se pjesa më e madhe e ndotjes nga aty buronte. Meqenëse nuk morën përgjigje nga asnjë prej institucioneve, ata organizuan një protestë duke kërkuar disa kërkesa. Edhe pse ata morën mbështetje verbale nga përfaqësuesit e komunës së Tetovës, nuk kishte zgjidhje konkrete për problemin brenda kompetencave të komunës. Ata vetëm formuan një grup pune, në të cilin ishin të ftuar përfaqësuesit e nismës qytetare, por pas dy takimeve, aktivistët qytetarë u tërhoqën nga ky grup. I pyetur nëse ata u përpoqën të mbledhin nënshkrime për të iniciuar një vendim më specifik nga komuna, përfaqësuesi i kësaj initiative qytetare u përgjigj se ata nuk kishin ndërmend të mbledhin nënshkrime, sepse nuk ishin të sigurt se do të ishin në gjendje të mbledhin nënshkrime të mjaftueshme nga qytetarët që dinin pak për atë që po ndodh me këtë problem.

Nga ana tjetër, përfaqësuesi i Komunës së Tetoves me të cilin diskutuam për këtë iniciativë, u përgjigj që në procesin e organizimit të protestave dhe sensibilizimit të publikut për këtë problem kan qenë të kycur edhe përfaqësues të komunës si mbështetje që të ofrohet zgjidhje për këtë dukuri të dëmshme për qytetarët. Sipas tij, organet e komunës shpesh kan diskutuar për këtë iniciativë dhe e kan mbështetur, kurse Këshilli komunal ka diskutuar dhe ka sjell një plan akcional për përmirësimin e gjendjes së ajrit në Tetovë, dhe mendon se problem kryesor me ndotjen në Tetovë deridiku është zgjidhur me mbylljen e “Jugotom”, i cili është vlersuar si ndotësi më I madh në qytet.

RAJONI PELLAGONISË

Edhe në rajonin planor të Pellagonisë ndryshimet në politikat lokale kan ndodhur me shtypje të qytetarëve nëpërmjet protestave dhe mbledhjes së nënshkrimeve. Të dy rastet janë të lidhura me qytetin e Manastirit.

Njëra iniciativë ka të bëjë me propozimin për shitjen e shtëpisë së Oficerëve, që nxiti pakënaqësi te qytetarët dhe u inicua mbledhje e nënshkrimeve. Iniciativa “Stop për shitjen e pasurisë historike dhe nacionale” u inicua nga Shoqata për kulturë dhe art “Makina”. Më vonë kjo iniciativë u vëndua si pik për diskutim në Këshillin e komunës së Manastirit. Nën shtypjen e qytetarëve dhe medimeve qëllimi i iniciativës ishte i suksesshëm dhe u tërhoq propozimi për shitjen e shtëpisë së Oficerëve. U mblodhën 3500 nënshkrime, mirëpo nuk u shfrytëzuan për iniciativën adekuate.

Inicijativa tjetër qytetare, e cila kishte të bëjë me kualitetin e ajrit, u inicua nga shoqata “Për ne bëhet fjalë”. Shoqata është mbledhur spontanisht, ku paraprakisht një nga antarët kishte bërë hulumtim se ajri në qytetin e Manastirit është i ndotur në masë të madhe. Më pas u themelua shoqata “Për ne bëhet fjalë” si subject juridik me qëllim që të inicojë si problem në nivel më të lartë. Në pyetjen se a kishin njohuri për rregullativën ligjore sa i përket iniciativave qytetare në nivel lokal, njëri nga iniciatorët u përgjigj se dy nga antarët kishin eksperiencë me punë juridike. Shoqata filloi të mbledh nënshkrime dhe shumë shpejtë mblodhën 1000 nënshkrime. Atëherës dërguan kërkesë deri të Komuna e Manastirit me qëllim që ky problem të vëndohet si pik e rendit të ditës të këshillit komunal. Kërkesa e tyre menjëherë u aprovua pa formularë apo dokumente dhtesë. Për këtë arsye ata edhe ndaluan të mbledhin nënshkrime pasi që u ftuan në seancë të këshillit për të biseduar dhe të propozojnë masa konkrete për zgjidhjen e këtij problem. Njëzër u angazhuan për ndërmarrjen e masave afatshkurte.

Pasiqë pas një afati të caktuar kohor nuk u morrën masa konkrete nga ana e komunës, shoqata organizoi protest në të cilin numër i madh i qytetarëve i dhanë përkrahje. Në rrjetin social fejsbuk kan krijuar shumë ngjarje prej nga i kan ftuar qytetarët në protesta. Takimi i rradhës ishte me kryetarin e Komunës së Manastirit, ku u nënshkruajtë edhe memorandum ndërmjet komunës dhe shoqatës. Dhe prap nuk u ndërmorrën masa në lidhje me problemin, dhe përshkak të tensioneve politike në shtet dhe në komunë, kërkesa për zgjidhje më konkrete për problemin gjithmonë shtyheshin. Sipas përfaqësuesit të iniciativës, kishte kërcnime ndaj individëve nga Shoqata dhe ajo ndaloi me aktivitete.

Përfaqësues i administratës së Komunës së Manastirit (Departamenti i planifikimit urbanistik dhe mbrojtjes së mjedisit), i cili në atë kohë kishte bashkëpunuar në njëfarë mënyre me Shoqatën, u përgjigj se kur iniciativa “Për ne bëhet fjalë” u vëndua në rend dite në Këshillit, në të njëjtën kohë, u zhvillua një program komunal për mbrojtjen e ajrit të ambientit. Më tej, për shkak të pengesave të dimensionit politik, nuk është ndërmarrë asnjë realizim lidhur me zbatimin e masave dhe programit. Autoritetet komunale nuk e diskutuan këtë çështje, që do të thotë se është diskutuar vetëm në këshillin e Komunës së Manastirit. Sidoqoftë, ky përfaqësues i administratës e vlerësoi iniciativën si pozitive, pasi shumë qytetarë ofruan mbështetje për një temë të rëndësishme që nuk u diskutua gjerësisht në publik.

RAJONI I VARDARIT

Një nga iniciativat më të dukshme qytetare në rajonin e Vardarit filloi në vitin 2008 dhe 2009 nga Koalicioni i Gjelbër (më shumë OJQ nga Velesi), kur u organizuan më shumë protesta qytetare për të parandaluar shitjen e Shkrites së Velesit për rifillimin me punë të saj. Si rezultat i gjithë këtyre protestave të organizuara, blerësi i mundshëm përfundimisht hoqi dorë nga ideja e blerjes dhe rifillimit të shkrirësit.

Në mënyrë të ngjashme, disa nisma qytetare u implementuan nga shoqatat e qytetarëve, prodhuesit e verës, fermerët individualë dhe qytetarë të tjerë të Komunës së Negotinës në periudhën 2009-2012 për të pezulluar ndërtimin e një shkrite afër Negotinës nga një kompani nga Kavadarci. Iniciativat janë nisur dhe zbatuar me miratimin e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dhe Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapsinor. Si rezultat i kësaj initiative madhore, procedurat e mëtejshme u pezulluan me vendim të Këshillit të Komunës së Negotinës.

Disa vjet më vonë, e njëjta kompani nga Kavadari mori miratimin nga Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapsinor dhe Ministria e Transportit dhe Lidhjeve për ndërtimin e një shkrite çeliku afër Kavadarit, pas së cilës kërkoi leje dhe miratim nga komuna e Kavadarit. Në vitin 2018, të organizuar nga Shoqata Eko - jetë, është nisur një iniciativë qytetare me sloganin "Industri e rëndë në shtëpi - Jo, faleminderit!", e cila filloi mbledhjen e nënshkrimeve kundër ndërtimit të kësaj shkrite.

Nisma erdhi nga disa anëtarë të jashtëm të organizatës lokale ekologjike Eko - jetë, pas së cilës udhëheqja e saj pranoi të organizojë një anketë publike me popullatën e komunës së Kavadarit për të vlerësuar disponimin e tyre në lidhje me këtë temë, e cila ishte një problem i vërtetë potencial për të gjithë qytetarët e saj. Rezultatet e sondazhit çonin në përfundimin se është e nevojshme të organizohet një peticion në nivelin komunal për të mundësuar të gjithë qytetarët që ndjehen të shqetësuar që të shprehen për këtë çështje.

Kjo ishte nisma e parë e madhe ekologjike në komunën e Kavadarit viteve të fundit. Ideja u mbështet nga disa organizata ekologjike më me përvojë nga e gjithë vendi, të cilët ofruan përvojat dhe këshillat e tyre. Gjithashtu, shumë gazetarë që kanë shkruar ose raportuar jo vetëm në mediat lokale, por edhe në ato rajonale dhe kombëtare, kanë afirmuar me sukses problemin dhe iniciativën qytetare.

Në atë fazë, organizatorët e iniciativës nuk kishin shumë kontakte me përfaqësuesit e komunës së Kavadarit. Takimet e shumta ishin më shumë informuese me qëllim që përfaqësuesit e komunës të njihen me idenë e përgjithshme, bazat e iniciativës dhe hapat e ardhshëm.

Për shkak të kohës së shkurtër për përfundimin e iniciativës, organizatorët nuk inicuan një procedurë përmes KSHZ-së, por siguruan fletore me mbishkrimin "JO për industrinë G1 në Kavadar", të shtypura me vulën e tyre dhe pas mbledhjes së nënshkrimeve edhe zyrtarisht u dorëzuan në arkivin e komunës së Kavadarit.

Organizatorët kanë arritur të mbledhin pak më shumë se 12,000 nënshkrime për mbështetje të iniciativës për një periudhë dy javore, gjatë së cilës janë ngritur dhjetëra pika kontrolli në pjesë të ndryshme të qytetit.

Organizatorët nuk kërkuan fonde për iniciativën nga askush, shpenzimet e vogla u mbuluan nga fondet e tyre, dhe e gjithë iniciativa ishte vullnetare jo vetëm nga anëtarët e tyre aktivë dhe aktivistët, por edhe nga shumë qytetarë të interesuar që në një farë mënyre ndjeheshin përgjegjës të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe të kontribuojnë në ndalimin e synimeve të firmës lokale.

I gjithë afirmimi dhe promovimi i idesë u realizua përmes faqes speciale të iniciativës në Facebook, e cila u nis nga organizata lokale Eko-jetë. Media lokale u dha vetëm disa intervista të shkurtra gjatë procedurës së mbledhjes së nënshkrimeve, kur vullnetarët mund të shiheshin në pika kontrolli të shumta rreth qytetit.

Autoritetet komunale diskutuan këtë iniciativë brenda punës së rregullt të organeve të tyre, por nuk u përfshinë drejtpërdrejt në ndonjë fazë të zbatimit të saj. Nisma ishte tërësisht qytetare dhe nuk përfshiu institucione vendore, rajonale ose kombëtare.

Këshilli diskutoi në seancën e parë pas dorëzimit të nënshkrimeve nga qytetarët, ku në rend dite ishte vendosur- që të merret vendim nëse do t'i jepte dritë jeshile kompanisë lokale për të filluar një proces për të ndërtuar një strukturë teknologjike që kërkon një leje G1¹. Nën presionin e rezultateve të iniciativës qytetare dhe numrit të madh të nënshkrimeve mbështetëse të mbledhura në një periudhë relativisht të shkurtër kohore, këshilltarët votuan njëzëri kundër kërkesës së kompanisë.

Me këtë është arritur qëllimi kryesor për të ecur përpara iniciativa. Pas kësaj iniciative, organizata gjithashtu luftoi për të marrë vendin e saj në komunë kur bëhet fjalë për diskutimin dhe zgjidhjen e problemeve të tilla ose të ngjashme në rajonin e Tikveshit, me një theks të veçantë për Komunën e Kavadarit.

Sipas përfaqësuesve të organizatorëve të iniciativës, të cilët u kontaktuan për qëllimin e këtij hulumtimi, ekzistonte një lobim i madh - presion nga "ana e kundërt", veçanërisht në fund të

¹ Planifikimi i tokës për përdorim në planet urbanistike dhe dokumentacionet e urbanistike – planore nga Ligji për planifikimin hapësinor dhe urbanistik bëhet me sistemin e klasës për dedikim. Sistemi i klasave për dedikim përbëhet nga gjashtë grupe të klasave: A - Strehimi; B - Qëllimet tregtare dhe afariste; V - Institucionet publike; G - Prodhimi, shpërndarja dhe shërbimet; D-Gjelbrimi, sporte, rekreacion dhe hapsira memoriale dhe E-Infrastrukturë. Brenda klasës G - Prodhimi, shpërndarja dhe shërbimet, ofrohen klasat e mëposhtme të përdorimeve: industri e rëndë G1; Industria e dritës G2; Shërbime G3 dhe depo G4.

iniciativës, kur u bë e qartë se një numër i madh i nënshkrimeve do të mblidheshin nga qytetarët e komunës së Kavadarit.

Referendumet në nivel komunal (2010-2020)

Data	Komuna	Pyetja	Numri i përgjithshëm i votuesve që votuan	Përqindja e votuesve që votuan	Trupi votues
26.04.2015	Qendër	A jeni për të mbajtur pamjen aktuale të fasadës së Qendrës tregtare të qytetit?	17.655	40,53%	43.560
23.04.2017	Gjevgjeli	A jeni për apo kundër hapjes së minierave të xeheve metalike në territorin e Komunës së Gjevgjelisë?	13.384	68,78%	19.458
11.06.2017	Bogdanci	A jeni për apo kundër ndalimit të ndërtimit të minierës Kazandol? A jeni për apo kundër hapjes së minierave dhe komplekseve minerare për burime minerale metalike në territorin e Komunës së Bogdancit?	4.231	61,16%	6.918
23.07.2017	Dojran	A jeni për apo kundër hapjes së minierave të xeheve metalike në territorin e komunës së Dojran?	1.407	51,22%	2.747
20.08.2017	Vallandovë	A jeni për apo kundër ndalimit të ndërtimit të minierës Kazandol? A jeni për apo kundër hapjes së minierave dhe komplekseve minerare për burime minerale metalike në territorin e Komunës së Vallandovës?	4.683	46,15%	10.141
03.09.2017	Bosillovë	A jeni për apo kundër ndalimit të ndërtimit të minierës për baker dh ar nw Illovicë? A jeni për apo kundër hapjes së minierave dhe komplekseve minerare për burime minerale metalike në territorin e Komunës së Bosillovë?	3.992	32,45%	6.151

17.09.2017	Novo Sellë	A jeni për apo kundër ndalimit të ndërtimit të minierës për baker dh ar nw Illovicë? A jeni për apo kundër hapjes së minierave minerale metalike në komunë?	4.517	39,51%	11.432
17.10.2017	Debërca	A jeni për apo kundër ndërtimit të një deponie rajonale të mbeturinave të ngurta në territorin e komunës së Debërcës?	3.149	68,09%	4.625
02.02.2020	Dojran	A jeni për apo kundër dhënies së një kontrate partneriteti publiko-privat për furnizimin me ujë të pijshëm, asgjësimin e ujërave të zeza urbane dhe shërbimet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane në komunën e Dojranit?	1.420	53,34%	2.622

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në shembujt e paraqitur, si dhe përvojën në terren të kryerjes së aktiviteteve që lidhen me pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në nivelin lokal, **OJQ-të që kanë kryer studimin u përballën me problemin e demotivimit të aktivizmit ose mungesën e besimit në aftësinë e qytetarëve për të ndikuar në vendimet e qeverisë, për shkak të dispozitave ligjore** që përcaktojnë që një përqindje e lartë e qytetarëve duhet të nënshkruhen në mbështetje të nismave qytetare dhe formave të tjera të vendimmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve për çështje të cilat janë shumë të rëndësishme për t'u lënë të përcaktohen vetëm nga një rreth i vogël njerëzish.

Një nga arsyet kryesore të mosveprimit alarmant të qytetarëve në zgjidhjen e problemeve lokale është pikërisht përcaktimi ligjor i një pragu të lartë si një kusht për angazhim më thelbësor të qytetarëve në kërkimin e zgjidhjeve ose iniciativave për ndryshimin e situatës në bashkësit lokale.

PËRFUNDIME:

-- Ligji për referendumin dhe format e tjera të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve nuk është në përputhje me iniciativat nacionale dhe lokale të referendunit. Shpallja e një referendumi në nivelin shtetëror kërkon 150,000 nënshkrime të qytetarëve me të drejtë vote, që përfaqësojnë më pak se 10% të votuesve të regjistruar në territorin e shtetit, ndërsa një referendum në nivelin e vetëqeverisjes lokale kërkon nënshkrime të 20% të votuesve të regjistruar. Një nga arsyet pse ka pasur shumë pak nisma të suksesshme të referendunit lokal është pikërisht kjo shkallë e lartë e censurit.

Sidoqoftë, është e nevojshme të mos anashkalohej fakti se referendimet si mjete demokratike mund të jenë kundërproduktive për një numër arsyesh. Duke pasur parasysh kërkesën për një përfshirje më të madhe të qytetarëve, energjia e çdo angazhimi qytetar do të drejtohej drejt mobilizimit ("ndjekja e numrave") dhe do të çaktivizonte qëllimet thelbësore dhe arsyet e iniciativës. Pastaj, procesi i fillimit të një referendumi mund të zgjasë shumë, të marrë kohë dhe të ngadalësojë proceset e tjera të dobishme.

- Ekziston mospërputhje në legjislacionin për referendimet dhe votimin për zgjedhjen e pushtetit në nivel shtetëror dhe pushtet lokal. Që një referendum kombëtar dhe lokal të ketë sukses, duhet që më shumë se 50% e votuesve të regjistruar të votojnë, ndërsa 40% e votuesve të regjistruar në listat zgjedhore mund të zgjedhen President. Nuk ka cenzus ligjor që kërkohet për zgjedhjen e deputetëve dhe për zgjedhjen e kryetarit dhe këshilltarit të komunave në mënyrë që zgjedhjet të jenë të suksesshme.

- Që të organizohet një tubim në nivelin lokal parashikohet mundësia e thirrjes me kërkesë të 10% të qytetarëve në një komunë apo lagje të caktuar, mirëpo ky hulumtim nuk tregoi një shembull të një iniciative të suksesshme të qytetarëve për të ruajtur këtë formë të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrjen në nivelin lokal. Në shembullin e përshkruar më lart me iniciativën në Karposh 4, iniciatorëve kishin qëllim për të organizuar një tubim të qytetarëve, por nuk arritën ta realizojnë atë. Shumica e komunave interpretojnë takimet e qytetarëve në bashkësit lokale me kryetarin e komunës si një tubim të qytetarëve, i cili formalisht mund të jetë në përputhje me ligjet, mirëpo ne nuk kemi marrë shembuj ku vendimet e marra në takime të tilla të organizuara janë zyrtarizuar në vendime të autoriteteve komunale. Dispozita në Ligjin për vetëqeverisjen lokale e cila parashikon çështjen e vetëqeverisjes lokale për të inicuar tubim të qytetarëve, siç kërkohet nga të paktën 10% e votuesve të vetëqeverisjes vendore me të cilat ka të bëjë çështja e veçantë, do të ishte më e realizueshme nëse do të ekzistonte një njësi në nivel lokal/rajonar i Komisionit shtetëror zgjedhor në çdo bashkësi lokale/urbane ose nëse lejohet mbledhje e nënshkrime në një mënyrë më pak të zyrtarizuar.

- Iniciativat qytetare që kufizojnë mbledhjen e nënshkrimeve për të ndryshuar një politikë, bëjnë më pak presion ndaj autoriteteve komunale dhe administratës në krahasim me nismat që përfshijnë tubime apo protesta në shkallë më të gjerë, të cilat shpesh tërheqin praninë më të madhe të mediave dhe dukshmërinë e nismave. Të tilla ishin protestat kundër hapjes së minierave në Juglindje, ose ndrimin të fasadës së GTC-së në Shkup, ose protestat në lidhje me problemet ekologjike në Tetovë dhe Manastir. Gjithashtu, tubimi i madh i qytetarëve në Debërc me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga të gjitha bashkësit lokale në komunë çoi në një mobilizim masiv të qytetarëve prapa një iniciative qytetare.

Studimi tregoi pa mëdyshje disa gjëra të rëndësishme.

Ambienti në të cilën shfaqen nismat qytetare është shumë i rëndësishëm. Të gjitha rastet e hetuara të iniciativave qytetare (të organizuara ose spontane) u inicuan në një kohë kur vendi u diagnostikua si një "Shtet i robëruar" nga grupi monitorues i Pribe dhe çdo iniciativë haste, për demokraci, në kundërshtim, të cilat ndonjëherë ishin në prag të dhunës . Iniciativat e atëhershme, sado të guximshme të ishin, në atë fazë, në atë mjedis, u heshtën, anashkaluan, u injoruan nga të gjitha nivelet e qeverisjes.

Vetëm pasi filluan proceset e çlirimit të "Shtetit të robëruar" (protesta masive qytetare, marrëveshje politike për krijimin e një mjedisi të pranueshëm që do të çonte në zgjedhje demokratike, zgjedhje parlamentare dhe procese për krijimin e një shumice parlamentare në 2017 dhe zgjedhje për qeverinë e re lokale në 2017) iniciativat e qytetarëve hasën një mjedis në të cilin argumentet e iniciativës gjetën një atmosferë produktive dhe në të shumtën e rasteve patën një rezultat pozitiv.

Në historinë e pjekurisë demokratike të vendit, është bërë e qartë se angazhimi qytetar është një përbërës i domosdoshëm i të gjitha proceseve demokratike, pavarësisht nëse është një mini-iniciativë lokale, apo çështje madhore politike.

Mësimet e nxjerra nga procesi i kryerjes së ndryshimeve demokratike shërbyen si mësim për elitat politike sepse ndryshimi demokratik nuk do të ishte i mundur pa pjesëmarrjen masive të qytetarëve që morën pjesë qoftë si individë ose si struktura të organizuara. Ata erdhën nga një qasje tjetër, nga një "dëgjim politik" i ndryshëm se si t'i drejtohen nismave të qytetarëve, gjë që tregon përsëri nevojën për një angazhim më intensiv që synon sensibilizimin e politikanëve dhe veçanërisht qytetarëve.

REKOMANDIME:

- Ulja e censurit për shpalljen e referendumit në nivel lokal në maksimum 10% të votuesve të regjistruar në nivelin e njësive të vetëqeverisjes lokale.
- Ulja e censurit ose mos të kërkohet census që një referendum të jetë i suksesshëm. Ashtu siç shumica e qytetarëve që votuan vendosin për zgjedhjet për qeverinë në nivel qendror ose lokal, parimi i shumicës së votuesve duhet të jetë vendimtar edhe për referendumet. Kjo do t'i motivojë votuesit të jenë aktivë në çështje me rëndësi nacionale ose lokale.
- Lejimi i mbledhjes së nënshkrimeve për të filluar tubimet e qytetarëve në formularët e marrë nga Komisioni shtetëror zgjedhor, por pa detyrimin që qytetarët të shkojnë në zyrën rajonale, shpesh të largët të Komisionit shtetëror zgjedhor, por të mbledhin nënshkrime nga persona të autorizuar nga iniciatorët. Në mënyrë të ngjashme, kjo procedurë mund të lehtësohet duke ofruar një platformë digjitale në internet për fillimin e tubimeve të qytetarëve, të cilat njësitë e qeverisjes lokale ose institucionet kombëtare do të mirëmbajnë në faqen e tyre të internetit.
- Kryerja e një regjistrimi të ri që do të tregojë numrin real të popullsisë, si në nivelin shtetëror ashtu edhe në atë komunal.
- Për të inkurajuar ndërgjegjësimin dhe nevojën për një angazhim të përhershëm qytetar që mishëron parimin e solidaritetit me çdo angazhim që përmban një qëllim të arsyeshëm. Qytetarët janë akoma me përvojë të pamjaftueshme që artikulojnë çdo iniciativë që kërkon bashkimin e individit me interesin kolektiv, të përgjithshëm, publik. Ky është një drejtim për të cilin duhet punuar gjithnjë dhe proceset e pjekurisë demokratike të shoqërisë për të cilën ata do të duhet të marrin në konsideratë dhe të punojnë. Kjo detyrë kryesisht i përket nismave qytetare të krijuara tashmë.